



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:033027

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05735689

C.nr.3266/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe me bashkëpunëtoren profesionale Fjolla Osmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses F.T., nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar Q.B-H., , për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor, vlera e kontestit 1,566.50 euro, jashtë seance me datë 27 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses F.T., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 24 muaj të kualifikimit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 31.01.2023, të ia paguajë shumën prej 1,446.00.-€ (njëmijë e katërqind e dyzet e gjashtë euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 27.12.2023 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses dhe atë për periudhën nga data 01.02.2023 deri me datë 06.02.2023, në shumën prej 60.25.-€, në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

III. HEDHET poshtë si e palejuar padia e paditëses F.T., nga Gjakova e paraqitur në gjykatë me datë 27.12.2023 ndaj të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor, sa i përket periudhës kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2021, në shumën prej 60.25.-€, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzet e katër euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja F.T., nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 27.12.2023, përmes të autorizuarve të saj Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj, që të dy avokatë në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse në SHFM “....” në Gjakovë. Ka kërkuar që në emër të kualifikimit, paditëses të i paguhet diferenca në pagë nga data 01.01.2021 deri me datë 06.02.2023, në shumën prej 1,566.50 euro, ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj Q.B-H., , në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 12.04.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se nga provat e prezantuara – listat e pagave të paditëses shihet se sa i përket shtesave nga e paditura mbi bazën e kualifikimit, të njëjtat përmbushen çdo muaj. Kërkesës së paditëses i mungon baza pasi që kjo e drejtë nuk i takon me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës. Sa i përket Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 i datës 29.08.2008, në asnjë pikë të tij nuk ekziston ndonjë detyrim të cilin Komuna e Gjakovës duhet ta përmbushë. Edhe nëse do të kishte, Qeveria nuk e ka mbështetur të paditurën me mjete financiare për ta përmbushur detyrimin e pretenduar. Periudha e kërkuar është e pamundur të realizohet pasi që nuk prodhojnë asnjë efekt juridik kontratat të cilat janë shkëputur me datë 21.11.2022. Tutje ka konsideruar se në rastin konkret kërkesëpadija e paditëses është parashkruar në tërësi, e po ashtu e njëjta as nuk i ka shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Po ashtu ka shtuar se bazuar në praktikat e deritanishme nga të gjitha instancat e Republikës së Kosovës, kompensimet e tilla kanë karakter deklarativ e jo detyrues, kjo për shkak se lihet në diskrecion të palëve kontraktuese të gjendet mundësia financiare. Tutje ka theksuar se ka indikacione që kemi të bëjmë me rast të gjykuar, ku ka kërkuar nga gjykata verifikimin e kësaj rrethane. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen, e lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “.....” në Gjakovë, si mësimdhënëse. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 459.00 euro dhe në emër të kualifikimit për çdo muaj i është paguar shuma prej 63.68 euro, pasi që e njëjta ka diplomuar me datë 31.05.2014 dhe ka marrë titullin profesional Profesor, fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës- Fakulteti i Filologjisë me numër 1997, e datës 25.05.2011. Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të

*kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.*

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”, ndërsa pika 4 nën-pika 3 e tij, ka përcaktuar se “Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare me titull Profesor, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 31.01.2023 apo për 24 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumën prej 60.25 euro për çdo muaj, për këtë kriter të kompensimit.*

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 01.02.2021 deri me datë 31.01.2023 të njëjtës nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit prej 60.25 euro, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”,* andaj në rastin konkret vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha pretendimet e përfaqësueses ligjore të të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, të cilat i refuzoi për arsyet si në vijim:

Fillimisht, sa i përket pretendimit të të paditurës se rasti ka të bëjë me çështje të gjykuar, gjykata gjeti se një pretendim i tillë është i pabazuar për periudhën kohore nga data 01.02.2021 deri me datë 31.01.2023, pasi që pas shikimit të të gjitha çështjeve juridike kontestimore të iniciuara nga paditësja lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, ka rezultuar se në këtë gjykatë lidhur me këtë kërkesë për paditësen është vendosur vetëm sa i përket periudhës 01.09.2018 deri me datë 31.01.2021 dhe atë me Aktgjykimin C.nr.1248/21 i datës 23.12.2022, ashtu që periudha e aprovuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nuk përfshin periudhën e gjykuar me aktgjykimin e lartcekur.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me atë se paditëses i paguhet për çdo muaj shtesa në bazë të kualifikimit, mirëpo siç vërtetohet nga listat e pagave, e paditura nuk e përmbush në tërësi këtë obligim, por vetëm një pjesë të saj, ashtu që përmes padisë, paditësja ka kërkuar vetëm pjesën tjetër të shtesave në emër të kualifikimit, ashtu siç gjykata lidhur me këtë ka vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Pretendimin se padisë i mungon baza ligjore, me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, gjykata e refuzoi për shkak se në rastin konkret baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008. Ndërsa sa i përket pretendimit se bazuar në këtë vendim, nuk obligohet në asnjë pikë të tij e paditura për përmbushjen e ndonjë detyrimi, gjykata vë në dukje që në pikën 8 të tij është përcaktuar se *“Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”*, pra edhe pse specifikisht nuk është përmendur e paditura, gjykata vë në dukje që burimi financiar i të paditurës por edhe MASHT-it rrjedh nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës, atëherë gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar.

Mungesën e pretenduar të buxhetit, gjykata e ka konsideruar si pretendim të pabazuar, pa mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme dhe i parëndësishëm për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësja nuk është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Vendimi numër 01/33.

I pabazuar rezulton të jetë edhe pretendimi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se paditësja ka kërkuar që kompensimi të i bëhet për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, e padinë e ka paraqitur me datë 27.12.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata analizoi edhe pretendimin tjetër në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzoi pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën, pasi që paditësja nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shtesave në bazë të kualifikimit, mirëpo e paditura ka qenë dashur që detyrimin e saj ta përmbushë në momentin që janë plotësuar kushtet bazuar në vendimin e lartcekur, e meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç kanë vepruar në rastin konkret paditësja.

Ndërsa sa i përket pretendimit se kërkesa për periudhën e kërkuar nga paditësja nuk mund të realizohet pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit nuk prodhon efekt juridik pas shkëputjes së saj me datë 21.11.2022, gjykata vë në dukje që baza e kërkesëpadisë është Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me

datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Gjykata vë në dukje që periudha sa ka qenë në fuqi ky vendim, përfshin tërë periudhën e kërkuar me padi nga paditësja për kompensimin e shtesave në bazë të kualifikimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht refuzoi si të pabazuar pjesën e kërkesëpadiës për periudhën kohore nga data 01.02.2023 deri me datë 06.02.2023, në shumën prej 60.25 euro, për shkak se paditësja ka kërkuar kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit për 26 muaj, duke përfshirë edhe muajin Shkurt 2023, mirëpo gjykata vë në dukje që Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, ka qenë në fuqi vetëm deri me datë 06.02.2023, ashtu që gjashtë (6) ditë të muajit Shkurt nuk mund të konsiderohen muaj i plotë, për të cilin do të i takonte kompensimi i lartcekur paditëses, andaj lidhur me këtë pjesë gjykata erdhi në përfundim që janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*, për çka vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi ka gjetur se për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2021 ekziston gjyqvarësia për faktin se lidhur me këtë periudhë kohore është proceduar më herët nga ana e kësaj gjykate, madje edhe është vendosur me aktgjykimin C.nr.1248/21 i datës 23.12.2022. Andaj, konform nenit 262 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku është përcaktuar se *“Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia.”*, si dhe paragrafi 3 i nenit të lartcekur, i plotësuar dhe ndryshuar me nenin 16 të Ligjit nr.04/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, është përcaktuar se *“Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë të paraqitur më vonë.”*, gjykata erdhi në përfundim që në rastin konkret padia për periudhën e lartcekur duhet të hudhet poshtë për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë, kjo duke u bazuar edhe në nenin 391 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se [...] c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca)”*, për çka vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vë në dukje se pavarësisht faktit se për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2021 është vendosur me aktgjykimin C.nr.1248/21 i datës 23.12.2022, e njëjta nuk mund të konsiderohet çështje e gjykuar, për shkak se ndaj atij aktgjykimi është ushtruar mjeti juridik – ankesa, për çka lënda gjendet në gjykatën e shkallës së dytë për vendosje, e që rrjedhimisht vendimi nuk është akoma i formës së prerë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, me ç‘rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.3266/23, datë 27.05.2024

Gj y q t a r j a,  
Mirjeta Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.